

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ





# Imam Aliu

(Paqja qoftë mbi të!)

**në fjalët e Imam Khameneit**

Tiranë, 2026

Titulli: **Imam Aliu në fjalët Imam Khameneit**

E përktheu: **Haxhi Shejkh Vullnet MERJA**

E redaktoi: **Jerida KULLA**

E korrektoi: **Ma. Isra MERJA**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie FEZA**

Kopertina: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata "Flladi" - Tiranë, 2026**

## Imam Aliu (Paqja goftë mbi të!) në fjalët e Sejid Ali Khameneit (*Allahu e ruajttë!*)

I Dërguari më i nderuar (Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) u tha një grupi shokësh të tij: *“Kush dëshiron të shohë Ademin në diturinë e tij, Ibrahimin në butësinë e tij, Musain në madhështinë e tij dhe Isain në adhurimin e tij, le të shikojë tek Ali ibn ebu Talibi”*.

Domethënë, dituria e Ademit, për të cilën është thënë në Kur'an: **“Dhe Ai ia mësoi Ademit të gjitha emrat”**, butësia e Ibrahimit, për të cilin Allahu ka thënë në Kur'an: **“Vërtet Ibrahim i ishte i butë, i përvuajtur dhe gjithmonë i kthyer nga Zoti”**, madhështia e Musait, para të cilit pushteti dhe madhëria e Faraonit ishin të dobëta, dhe adhurimi i Isait, i cili ishte shembull i asketizmit, i sinqeritetit dhe i përkushtimit ndaj Allahut. Në disa transmetime, që kanë ardhur edhe nga joshi'itët, është shtuar edhe një cilësi tjetër: asketizmi i Jahja ibn Zekerias. Të gjitha këto virtyte janë bashkuar te ky njeri i madh, prej të cilit ne krenohemi që jemi ndjekësit e tij. Ai është Imam Aliu (Paqja goftë mbi të!).

## **Besimi në Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!)**

Prijësi i besimtarëve është imami ynë dhe imami i të gjithë myslimanëve. Do të thotë se të gjithë e pranojnë atë si Imam. Por çfarë kuptimi ka fjala imam? Ajo do të thotë që ne duhet t'i shohim dimensionet e këtij personaliteti si një model të lartë që e vendosim përpara vetes, e pastaj të përpiqemi të ndërtojmë diçka të ngjashme me të.

Si mundet dikush të pretendojë se është nga ndjekësit (shi'itët) e Prijësit të besimtarëve dhe nuk guxon t'i kundërshtojë armiqtë e Allahut nga frika e pushtetit dhe e arrogancës së tyre?

## **Lufta e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) kundër arrogantëve**

Ata që i luftoi Prijësi i besimtarëve gjatë ditëve të udhëheqjes (kalifatit) së tij dhe para kësaj, ishin armiq të fesë. Ata kishin pushtet politik dhe ushtarak. Disa prej tyre kishin mbështetje popullore dhe ndikim, madje pretendonin besim dhe shenjtëri. Disa, si havarixhët, ishin të ngjashëm me disa ekstremistë që shfaqen si revolucionarë, të cilët nuk pranonin askënd tjetër përveç vetes, ashtu siç pati disa që, në fillim të Revolucionit, nuk e pranuan Imam Khomeinin si figurë revolucionare.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), i përballoi ata, i shpërndau dhe tha se po të mos i kishte luftuar, askush tjetër nuk do të kishte guxuar të ngrihej kundër tyre.

Sot, ka disa që pretendojnë se Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) është imami i tyre, por nuk janë të gatshëm të thonë qoftë edhe një fjalë që të shqetësojë mendjemëdhenjtë, Amerikën dhe ata që sot ushtrojnë padrejtësi, qindra herë më shumë se sunduesit e korrumpuar në fillim të Islamit. Ata, në një ditë, kryejnë aq shumë padrejtësi, sa kryen të tjerët në disa vite. E megjithatë, këta thonë se janë shi'itë (ndjekës) të Aliut dhe se ai është Imami i tyre.

## Shembulli më i mirë

Askush nuk mund të presë që të arrijë qoftë edhe në një largësi të vogël prej nivelit të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Kjo është një e vërtetë. Kam thënë disa vite më parë, në namazin e xhumasë se ne nuk mund të jemi si Prijës i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!). Atëherë njëri më shkroi, duke më thënë: 'Po, ju e qetësuat veten me këtë fjalë, sepse nuk jeni në gjendje të jeni si Prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!)'. Por jo, çështja nuk është kjo. Vetë Prijësi i besimtarëve ka thënë në një hadith: *"Por ju nuk mundeni ta bëni këtë"*. Ai është në majë. Imagjinoni një majë të lartë. Ne duhet të ngjitemi drejt saj. Nuk duhet të themi se nuk arrijmë dot, por duhet të lëvizim në atë drejtim.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), është shembull për të gjithë përgjegjësit e institucioneve shtetërore, në çdo strukturë administrative e qeveritare, pavarësisht përgjegjësisë së tyre, e vogël apo e madhe. Ai na ka kërkuar të punojmë me sinqeritet, ta kryejmë punën për njerëzit, pa ua kujtuar, si të ishim duke u bërë ndonjë nder, t'i respektojmë ata që kemi përballë dhe të mos i nënçmojmë, të kemi duar, sy dhe gjuhë të pastra, madje edhe zemër të pastër.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), punoi për ringjalljen dhe ngritjen e njerëzve. Nuk është keq që këtu të përmend edhe çështjen e arsimit, pasi në këtë

mbledhje janë të pranishme një grup motrash që punojnë në lëvizjen për zhdukjen e analfabetizmit.

## **Ecja në rrugën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)**

Kjo qeveri, e cila është formuar sot në sistemin e Republikës Islamike, pas shumë shekujsh, është një qeveri që ecën në rrugën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Ndërsa të tjerët lëvizin në drejtim të kundërt dhe në pikën e kundërt me atë që dëshironte Prijësi i besimtarëve.

Kjo qeveri po ecën në atë rrugë, prandaj duhet mbështetur, duhen ecur bashkë me të dhe i duhet dhënë përkrahje, si edhe duhet kujtuar për mangësitë e saj në mënyrë vëllazërore dhe miqësore, në mënyrë që të mund të ruajë këtë rrugë të drejtë.

Të padrejtët (kësitët), khavarixhët dhe thyesit e besëlidhjes e kundërshtojnë qeverinë e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), kurse jobesimtarët që qëndronin pas tyre, i kundërviheshin dhe e luftonin atë.

## Porosia e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)

Ka një porosi të shkurtër të Imam Aliut, të cilën ai e la, pasi u plagos, në natën e nëntëmbëdhjetë të muajit të bekuar të Ramazanit, të cilën dëshiroj ta shpjegoj për ju. Arsyeja e rëndësisë së kësaj porosie është se njeriu, në çastet e fundit të jetës së tij, përpiket të shpalosë të vërtetat e mendimeve, bindjeve dhe fshehtësive të zemrës së tij te njerëzit më të mirë dhe më të besuar për të.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), është mrekullia e krijimit, njeriu i dytë pas Profetit më të nderuar (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), një mysliman luftëtar në rrugën e Allahut (*"u përpoq për Allahun ashtu siç e meriton Ai"*), asket, udhëheqës dhe politikan i klasit të parë. Pozita e tij në qiell është më e njohur se sa në tokë, dhe dashamirët e tij, nga engjëjt e qiellit, janë më të shumtë se dashamirët e tij, nga njerëzit e tokës.

Një njeri i tillë, i lidhur me mbretërinë e lartë shpirtërore dhe i ditur për të gjitha njohuritë hyjnore të larta, që zotëron gjithë këto cilësi e virtyte, kur ndien se fundi i jetës së tij po afrohet dhe koha po kalon shpejt, duhet medoemos të nxitojë në shpalljen e çështjeve më të rëndësishme.

Kur ai u godit në xhami, e dinte se jeta e tij ishte drejt përfundimit, prandaj dëshironte t' u linte një porosi fëmijëve të tij, banorëve të Kufes dhe gjithë myslimanëve të hutuar të asaj kohe, duke lëshuar një mesazh të shkurtër, por që do të mbetej i pavdekshëm përgjatë historisë. Ai i zgjodhi fjalët e këtij mesazhi me një kujdes të jashtëzakonshëm.

Kur njeriu e lexon këtë porosi me një vështrim sipërfaqësor, mund t' i duket sikur ka mungesë harmonie ndërmjet pjesëve të saj. Ndonjëherë ai porosit për një çështje që, nga këndvështrimi ynë, duket me rëndësi të madhe, e menjëherë pas saj kalon në një tjetër që, sipas nesh, nuk ka të njëjtin peshim. Por, këndvështrimi i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) ndaj gjërave është si këndvështrimi i Allahut ndaj të gjitha krijesave të botës, një shikim hyjnor, i drejtë dhe gjithëpërfshirës. E madhe apo e vogël, çështjet ndryshojnë krejtësisht në peshën e masës hyjnore dhe të masës alevite, krahasuar me matjet tona njerëzore.

Ne jemi të paaftë për ta arritur atë nivel, por, kur analizojmë ato fjalë, edhe sikur nga larg, do të gjejmë se ato janë plotësisht të harmonizuara dhe të rregulluara me një kujdes jashtëzakonisht të madh. Prandaj, le t' i dëgjojmë ato me vëmendje dhe përqendrim.

## Ndër porositë e tij drejtuar Hasanit dhe Hysenit Paqja qoftë mbi ta!

Pasi u godit nga Ibn Muxhemi (Allahu e mallkoftë!), ai i thirri Hasanin dhe Hysenin dhe u la këto porosi, pavarësisht dhimbjes dhe etheve që ndiente nga përhapja e helmit në trupin e tij të pastër. Dhimbje të tilla do ta pengonin një njeri të zakonshëm të kryente detyrat e tij, por ato nuk mund ta pengonin një njeri si Aliu (Paqja qoftë mbi të!). Ai deshi të përfitonte nga ato orë të pakta, mes goditjes dhe martirizimit së tij, të cilat nuk i kaluan 48 orë, për të kryer punët më të domosdoshme, dhe më e rëndësishmja ndër to ishte porosia e tij: *“Ju porosis të keni frikë nga Allahu”*.

Ai e filloi porosinë e tij pa asnjë hyrje tjetër, duke filluar menjëherë me thirrjen për të pasur devotshmëri ndaj Allahut të Lartësuar. Në xhumanë e parë të muajit Ramazan kam folur shkurtimisht rreth çështjes së devotshmërisë.

Devotshmëria është gjithçka për njeriun; ajo është dynjaja dhe ahireti i umetit, është udhëtimi i vërtetë për këtë rrugë të gjatë që njerëzimi duhet ta përshkojë. Devotshmëria është fjala e parë dhe e fundit e Prijësit të besimtarëve dhe qëndron përpara çdo gjëje tjetër në jetën e njeriut. Sikur ai të dëshironte të thoshte: *“O bijtë e mi, duhet të vëzhgoni veten tuaj dhe veprat tuaja, duke i peshuar ato me matësin e drejtë hyjnor”*.

Fjalët e tij nuk kanë të bëjnë vetëm me çështjen e frikës nga Allahu, ashtu siç e kanë interpretuar disa, duke e shpjeguar devotshmërinë si frikë dhe drojë nga Allahu i Madhëruar. Është e vërtetë që frika dhe respekti i thellë ndaj Allahut kanë vlerë dhe llogariten si një lloj devotshmërie, por devotshmëri e vërtetë do të thotë vëzhgimi i vazhdueshëm i njeriut mbi veprat e tij, që ato të përputhen me interesat hyjnore që Zoti i Madhëruar ia ka caktuar. Kjo është një gjendje nga e cila njeriu nuk mund të heqë dorë, në asnjë rrethanë.

Nëse përpiqemi të heqim dorë nga kjo gjendje, rruga përpara nesh është e mbushur me rreziqe e lugina nën këmbët tona është e thellë, dhe pa dyshim do të rrëshqasim. Por, ndoshta mund të hasim në një gur apo një pemë për t'u kapur fort, që ndoshta të na ndihmojë të ngjitemi përsëri lart. Allahu i Madhëruar thotë: **“Vërtet, ata që janë të devotshëm, kur i prek ndonjë ngasje nga shejtani, ata e kujtojnë (Allahun), dhe menjëherë shohin qartë”**.

Njeriu i devotshëm, kur ndien se shejtani e ka prekur, menjëherë e kujton Allahun dhe kthehet te vetvetja, me vëzhgim dhe llogaridhënie. Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e dinte se shejtani nuk do të na lërë kurrë rehat, prandaj pjesa e parë e porosisë së tij duhej të ishte devotshmëria ndaj Allahut të Madhëruar. Pas kësaj ai filloi të këshillonte edhe për çështje të tjera të rëndësishme. Tha: “Mos e kërkon botën, edhe nëse ajo vjen te ju”.

Kjo është pjesa e parë; dhe ajo është nga domosdoshmëritë e devotshmërisë. Në fakt, të gjitha veprat e mira janë nga domosdoshmëritë e devotshmërisë. Një prej tyre është ky urdhër i tij. Ai nuk tha “braktiseni botën”, por këshilloi që të mos ndiqet bota, ose me fjalë të tjera, të mos vrapohet pas saj.

Por çfarë është kjo botë, të cilën nuk duhet ta ndjekim? A nënkupton ajo zhvillimin e tokës dhe shfrytëzimin e pasurive natyrore? A është kjo bota që e qortoi dhe nga e cila paralajmëroi Prijësi i besimtarëve? Jo, nuk është kështu.

Pra, dynjaja, të cilën nuk duhet ta ndjekim me lakmi, do të thotë kërkimi i kënaqësive dhe ndjekja e epsheve. Ndërsa, nëse qëllimi nga zhvillimi i tokës është e mira dhe përmirësimi i njerëzimit, atëherë ky është vetë Ahireti, dhe është një çështje, për të cilën duhet të përpiqemi.

Sa për dynjanë e qortuar, nga e cila njeriu është ndaluar ta ndjekë, ajo përfshin ato vepra që e pengojnë njeriun të ecë në rrugën e së mirës dhe të së drejtës, ia shterojnë vullnetin, ia konsumojnë fuqitë dhe përpjekjet. Ajo nënkupton egoizmin, dashurinë e vetes, etjen për pasuri dhe ndjekjen e kënaqësive.

Kjo dynja ndahet në dy lloje: një pjesë e saj është e lejuar (e mubahut), kurse pjesa tjetër është e ndaluar

(haram). Nuk është çdo gjë që kërkon njeriu për vete prej kënaqësive haram, por edhe në gjërat e lejuara ka rrezik.

Prandaj Ehli Bejti këshillon që të largohemi edhe nga kënaqësitë e lejuara, kur qëllimi i njeriut nga jeta bëhet vetëm ndjekja e epsheve dhe e kënaqësive. Përpiquni që të gjitha aspektet e jetës suaj materiale dhe shpirtërore të ecin në drejtimin hyjnor, të përcaktuar për to.

Në fakt, të gjitha punët e kësaj bote mund të vendosen në këtë rrugë, nëse qëllimi prej tyre është një qëllim i shenjtë. Edhe tregtia, për shembull, mund të jetë në rrugën e Allahut, kur qëllimi prej saj është përmirësimi i gjendjes ekonomike të shoqërisë dhe jo vetëm grumbullimi i pasurive të shumta.

**Pjesa e dytë** e testamentit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) ishte që të mos ndjekim dynjanë, sipas kuptimit që përmendëm më sipër. Në të vërtetë, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ishte shembulli më i përsosur i atyre porosive, pasi ai i mishëroi ato plotësisht në jetën dhe sjelljen e tij. Nëse hedhim një vështrim në jetën e tij, do ta shohim si një pasqyrim të gjallë të gjithçkaje që ai porositi.

**Pjesa e tretë:** *“Mos u pikëlloni për asgjë që ju është larguar nga kjo botë”,* domethënë, mos u hidhëroni për një pasuri, kënaqësi apo pozitë që nuk e keni fituar. Mos u dëshpëroni, pse nuk keni mjetet e rehatit dhe të begatisë;

mos u pikëlloni për asgjë, sepse nga kjo botë e ulët do të largoheni përgjithmonë.

**Pjesa e katërt:** *“Thoni të vërtetën”* (në një variant tjetër: *“flisni për të drejtën”*), dhe nuk ka dallim mes tyre. Kuptimi i saj është: mos e fshihni asgjë, kur e besoni se ajo është e vërtetë; duhet ta shpallni atë, kur rrethanat e kërkojnë. Të gjitha fatkeqësitë që kanë goditur shoqëritë, kanë ardhur, sepse ata që e dinin të vërtetën, e kanë fshehur dhe nuk janë përpjekur ta shpallin, përkundrazi, nganjëherë janë përpjekur ta shfaqin të rremën ose ta shndërrojnë atë në të vërtetë. Por e vërteta nuk do të shtypej kurrë, sikur ata që e njihnin, të kishin marrë nismën për ta përhapur dhe për ta shpallur. Atëherë pasuesit e së rremes nuk do të guxonin të mendonin për ta shuar atë.

**Pjesa e pestë:** *“Punoni për shpërblimin”*, domethënë, për shpërblimin e vërtetë dhe hyjnor. O njeri, mos puno kot. Jeta jote, puna jote dhe madje edhe frymëmarrjet e tua janë kapitali yt i vetëm dhe i vërtetë. Mos e shpërdoro.

Nëse dëshiron të bësh një punë, të marrësh një frymë, ose të harxhosh fuqinë tënde për diçka, le të jetë kjo për të fituar një shpërblim që përputhet me të. Cili është ky shpërblim, që duhet ta fitojmë? A janë disa monedha të numëruara që i marrim? A është kënaqësia e këtij apo atij njeriu? A janë këto gjëra shpërblimi i vërtetë për humbjen e jetës së njeriut? Sigurisht që përgjigjja është jo.

Më kujtohet një rrëfim nga Imami Sexhadi (Paqja qoftë mbi të!), i cili ka thënë: *“Shpirtrat tuaj nuk kanë asnjë çmim përveçse Xhenetit; pra, mos i shisni me diçka tjetër”*. Pra, nëse shpërblimi është më i vogël se kaq, humbja do të jetë fati ynë. Prandaj, veprat tona duhet të jenë vetëm për shpërblimin e vërtetë, që është shpërblimi i Botës Tjetër.

**Pjesa e gjashtë:** *“...bëhuni kundërshtar i të padrejtisë dhe ndihmës i të shtypurit”*. Të jesh kundërshtar, nuk është njësoj si të jesh armik; urrejtja ndaj padrejtësisë dhe armiqësimi me të padrejtin nuk mjaftojnë, sepse të jesh kundërshtar nënkupton që t’i kundërvihesh të padrejtisë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të mos e lësh të lirë.

Që nga vdekja e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) e deri më sot, njerëzimi ka jetuar në errësirë për shkak të mosqëndrimit të hapur kundër tiranëve. Po të kishin duart besimtarët, duke ngushtuar rrethin ndaj shtypësve, padrejtësia nuk do të kishte pasur mundësinë të përhapej në këtë shkallë; përkundrazi, ajo do të ishte kufizuar, do të ishte rrëzuar dhe do të ishte shuar.

Ajo që kërkon Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) është: *“Ji kundërshtar i të padrejtisë”* – domethënë, kudo që ka një padrejtësi, njeriu duhet ta kundërshtojë atë dhe të përpiqet që ta vërë në vend drejtësinë.

Nuk është e domosdoshme që ky kundërshtim të jetë gjithmonë i dukshëm, por, kur të vijë momenti, duhet ta

shfaqësh këtë qëndrim, qoftë edhe nga larg, nëse nuk është e mundur nga afër. Sot, shohim se bota po mbytet në një moçal të poshtërimit, për shkak se është lënë pas dore kjo pjesë e testamentit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).

Sa poshtërim dhe nënçmim po përjeton njerëzimi sot, dhe çfarë padrejtësish po kalojnë popujt islamikë për shkak të largimit nga Islami! Po të ishte vepruar sipas kësaj pjese të testamentit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), nuk do të shihnim sot as shumicën e këtyre padrejtësive e as fatkeqësitë që rrjedhin prej tyre.

Ai thekson edhe një çështje tjetër të rëndësishme: *“Dhe ndihmës i të shtypurit”*, që do të thotë, nëse sheh dikë të shtypur, ndihmoje atë. Ai nuk tha vetëm qëndro përkrah tij, por tha se duhet ta ndihmosh me çdo gjë që ke mundësi dhe aq sa ta lejon fuqia.

Deri këtu, këshilla i drejtohej Imam Hasanit dhe Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi ta!), por natyrisht, kjo nuk është e kufizuar vetëm për ta. Edhe pse fjalët u drejtoheshin atyre, testamenti i tij është i përgjithshëm dhe i përfshin të gjithë.

Në vazhdim, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të) u drejtohet të gjithëve, në mënyrë të përgjithshme dhe thotë: *“Ju këshilloj juve të dyve, gjithë fëmijët e mi, familjen time dhe çdokujt që i arrin letra ime”*. Pra, edhe ne që jemi këtu e dëgjojmë këtë testament, jemi të përfshirë në këtë këshillë.

Pastaj ai fillon pjesën e dytë të testamentit të tij të përgjithshëm. Sërish thekson rëndësinë e devotshmërisë (tekuasë), sepse devotshmëria është fjala e parë dhe e fundit e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).

Pas porosisë për devotshmëri, ai thotë: *“dhe rregullimin e çështjeve tuaja”*. Çfarë do të thotë kjo? A nënkupton që veprimet e përditshme në jetën tuaj duhet të jenë të organizuara dhe të sakta? Është e mundur që kjo të jetë një nga kuptimet, por ai nuk tha: *“rregulloni çështjet tuaja”*, por tha: *“rregullimin e çështjes suaj”*, pra, në njëjës. Kjo tregon se bëhet fjalë për një çështje të rëndësishme që duhet të përmbushet sipas rregullave dhe kriterëve të caktuara. Cila është kjo çështje?

Kuptohet se kjo *“çështje”* ka një element të përbashkët për të gjithë njerëzit dhe mund të nënkuptojë krijimin e udhëheqjes islame dhe të sistemit islam. Domethënë, o myslimanë, marrëdhënia juaj me qeverinë dhe sistemin duhet të jetë sipas rregullave dhe parimeve të qarta. Nuk duhet të ketë shpërfillje në këtë marrëdhënie.

Për shkak të kësaj shpërfilljeje, umeti islam ka përfunduar në degradim dhe përçarje. Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), në lidhje me këtë çështje, ka thënë: *“Nëse umeti i jep besën një Imami që është i kënaqur nga Allahu, nuk i lejohet askujt ta kundërshtojë atë”*. Sikur umeti islam të kishte vepruar sipas përmbajtjes së këtij hadithi, pasi ia dha besën Imam Aliut

(Paqja qoftë mbi të!), nuk do të ndodhnin ato luftëra shkatërruese, si: Lufta e Xhemelit, e Sifinit dhe e Nehrevanit.

Ky “çrregullim dhe shpërfillje” është ajo që bëjnë disa njerëz për interesat e tyre personale dhe për të kënaqur dëshirat e tyre, duke përhapur frikë në vend, duke nxitur trazira, duke dëmtuar rendin publik dhe duke vrrarë njerëz të pafajshëm këtu e atje. Kjo është një nga sprovat më të mëdha që Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) na ka paralajmëruar.

Paragrafi i tretë i pjesës së dytë të testamentit: *“Dhe përmirësimi i marrëdhënieve mes jush”*, domethënë, zemrat tuaja të jenë të pastra nga urrejtja, fjala juaj të jetë një dhe të mos përçaheni e të mos e kundërshtoni njëri-tjetrin. Marrëdhëniet mes jush të jenë vëllazërore dhe të mira.

Pastaj, ai, për ta mbështetur këtë këshillë, sjell një hadith nga Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!), gjë që tregon për rëndësinë e madhe që i kushton kësaj çështjeje, jo sepse është më e rëndësishme se organizimi i çështjeve (*nidhamul amr*), por sepse “përmirësimi i marrëdhënieve” është më i rrezikuar nga dëmtimi, se sa organizimi i punëve, prandaj, ai e mbështet këtë këshillë me një hadith të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) si theksim të veçantë për rëndësinë e saj: *“Sepse kam dëgjuar gjyshin tuaj duke thënë: ‘Përmirësimi i marrëdhënieve është më i mirë se shumë lutje e agjërimi’”*, nuk tha më i mirë se çdo lloj

namazi e agjërimi, por më i mirë se namazi dhe agjërimi në përgjithësi.

Pra, nëse ti do të falësh një namaz apo të agjërosh, kjo është në rregull, por ka një vepër më të mirë se këto, dhe ajo është të punosh për të pajtuar njerëzit dhe për të larguar përçarjen mes tyre. Nëse sheh ndarje dhe përçarje midis pjesëtarëve të umetit islam, duhet të përpiqesh ta largosh këtë ndarje, sepse kjo vepër është më e vlefshme se namazi dhe agjërimi i përgjithshëm.

Pas këtyre fjalëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) vazhdon me këshilla të tjera të shkurtra, por thelbësore dhe prekëse: *“Për Zotin, për Zotin, për jetimët! Mos lejoni që gojët e tyre të jenë të uritura dhe mos i lini të humbasin ndër ju”*. Këto fjalë na kujtojnë gjithmonë ndihmën ndaj tyre.

Ky njeri i madh, njohës i Allahut, me një zemër të ndjeshme, i shikon të gjitha çështjet me saktësi dhe hollësi. Nuk e sheh çështjen vetëm si ndjenjë apo lëmoshë personale. Një njeri që ka humbur babain e tij, ka humbur një nga nevojat më të rëndësishme të jetës, atë për një baba. Duhet të përpiqemi vazhdimisht për t’ia mbushur këtë boshllëk, që i është krijuar në jetë. Edhe pse nuk mund të zëvendësohet në tërësi, ti ke për detyrë të kujdesesh për atë fëmijë, për atë djalë apo të ri jetim, në mënyrë që të mos përfundojë në humbje e shkatërrim.

Duhet t' u siguron kafshatën e gojës, që të mos vuajnë nga uria dhe privimi. Mos i ndihmoni një ditë dhe t' i braktisni ditën tjetër. Shoqëria duhet të kujdeset për aspektin material të jetimëve dhe kurrsesi mos lejoni që ata të humbasin, përderisa ju jeni të pranishëm dhe të vetëdijshëm për gjendjen e tyre.

Mund të jeni të falur, nëse nuk e dini gjendjen e tyre ose nuk jeni të pranishëm, por nuk ka asnjë arsyetim, nëse një jetim braktiset, ndërkohë që ti je aty dhe e di çfarë po ndodh. Mos u merrni vetëm me punët tuaja personale dhe ta lini jetimin vetëm të përballet me sfidat e jetës”.

Më pas Imami u tha: *“Për Zotin, për Zotin, për fqinjët tuaj!”*, mos e nënvlerësoni çështjen e fqinjësisë, sepse është shumë e rëndësishme. Ajo lidhje e ngushtë sociale që Islami e ndërtoi mbi bazën e natyrës së shëndoshë njerëzore është, për fat të keq, shkatërruar në rrjedhat e modernizimit, që janë larg natyrës dhe instinktit të pastër njerëzor.

Ka njerëz që jetojnë për vite të tëra në një shtëpi dhe nuk e njohin fare fqinjin e tyre, nuk dinë çfarë po përjeton ai dhe nuk e ndihmojnë në nevojat e tij jetike.

Nëse do të vepronim sipas kësaj pjese të testamentit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe secili prej nesh do të kujdesej për fqinjët e vet, jo vetëm nga ana ekonomike dhe financiare, që edhe ajo është e rëndësishme, por nga çdo aspekt njerëzor, atëherë do të shihnim se sa shumë dashuri

dhe afërsi do të mbizotëronte në marrëdhëniet sociale në shoqërinë islame, dhe do të shihnim se si do të shërohej shoqëria nga sëmundjet e saj të përhershme sociale.

Ai vazhdon për fqinjët dhe thotë: *“Sepse ata janë amaneti i Profetit tuaj; ai vazhdimisht na këshillonte për ta, derisa menduam se do t’i bënte trashëgimtarë. Për Zotin, për Zotin, për Kur’anin! Mos lejoni që të tjerët t’ju paraprijnë në zbatimin e tij!”* Mos lejoni që ata që nuk kanë besim në Kur’an, të veprojnë sipas mësimëve të tij, më mirë se ju, që besoni. Nëse ata ju tejkalojnë në praktikimin e koncepteve hyjnore, do të ngelni pas. Kjo është pikërisht ajo që ka ndodhur.

Popujt që kanë përparuar në botë, kanë arritur këtë nivel falë përkushtimit serioz në punë, përpikërisë, ndjekjes së detyrave, vlerësimit të kohës dhe cilësisë së prodhimit, si dhe tipareve të tjera që i pëlqen Allahu, e jo përmes korrupsionit, alkoolit dhe padrejtësisë siç mendojnë disa.

E kam thënë shumë herë: përparimi shkencor nuk do të kishte qenë i mundur pa disa virtyte të lavdërueshme që u gjetën në shoqëritë perëndimore. Përndryshe, ato do të ishin shkatërruar prej padrejtësisë dhe tiranisë së tyre. Janë pikërisht ato virtyte të mira që i kanë shpëtuar ata nga shkatërrimi.

Por, fatkeqësisht, ne i kemi braktisur ato cilësi dhe kemi përfunduar në këtë gjendje që jemi sot.

Nëse punëtorët tanë, bujqit, dijetarët, profesorët, studentët dhe të gjitha shtresat e shoqërisë do t'i përqafojnë ato virtyte të lavdërueshme, vendi do të shndërrohet në një kopsht, ku të gjithë do të jetonin në begati. Kjo është mënyra e vërtetë për të vepruar sipas mësimave të Kur'anit.

Fjalja "Mos lejoni që të tjerët t'ju paraprijnë në zbatimin e Kur'anit" nuk do të thotë se Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) nuk dëshiron që të tjerët të veprojnë sipas Kur'anit; përkundrazi, po të vepronin të gjithë sipas urdhrave të Kur'anit, ky do të ishte një gëzim i madh për Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!). Por ai thotë se nuk duhet të ndodhë që dikush që nuk beson në Kur'an, të veprojë sipas vlerave dhe parimeve të tij, ndërsa ju, që besoni, të mbeteni pas, sepse kjo do t'u jepte atyre përparësi dhe pushtet mbi ju, për shkak të moszbatimit të mësimave të Kur'anit të shenjtë prej jush.

Më pas, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) thotë: "Për Zotin, për Zotin, kujdesuni për namazin, sepse ai është shtylla e fesë suaj. Për Zotin, për Zotin, për shtëpinë e Zotit tuaj (Qaben), mos e lini të braktisur për aq kohë sa jetoni, sepse, nëse ajo lihet e boshatisur, nuk do të jeni më në gjendje të qëndroni dot në këtë jetë". Mos e lini shtëpinë e Zotit të zbrazët. Nëse ajo braktiset, Allahu i Lartësuar nuk do t'ju japë më afat apo nuk do të mund ta vazhdoni më jetën. Kjo frazë është interpretuar në mënyra të ndryshme.

"Për Zotin, për Zotin, për xhihadin me pasurinë, jetën dhe fjalën tuaj në rrugë të Allahut!" Mos e braktisni xhihadin në

rrugën e Allahut, as me pasurinë, as me shpirtin dhe as me fjalën tuaj. Umeti islam ka qenë shembull për botën, përderisa e ka përmbushur urdhrin e xhihadit në rrugën e Allahut. Por, kur e braktisi këtë detyrë hyjnore, u përul dhe u nënçmua.

Shkrimtarët e krishterë, në Ungjillin e tyre, e përmendin Jezusin (Paqja qoftë mbi të!), duke thënë: *“Nëse dikush të godet në faqen e djathtë, ktheja faqen e majtë”*. Me këtë, ata nënkuptojnë se janë paqedashës dhe nuk e njohin luftën, se parimi i tyre është mëshira dhe paqja. Ata vazhdojnë ta përsërisin këtë pa turp dhe t’i sulmojnë myslimanët, duke i akuzuar si njerëz lufte, gjaku dhe shpatash.

Këto shpifje i kanë përhapur aq shumë, sa disa myslimanë kanë filluar të ndihen në siklet nga vetë konceptet e shenjta islame. Kjo ka bërë që disa dijetarë dhe autorë myslimanë ta mohojnë fare ekzistencën e xhihadit në Islam, duke thënë: *‘Xhihadi ynë është vetëm mbrojtje’*.

Po çfarë është ky mendim i dobët? Allahu i Lartësuar urdhëron: **“Luftoni në rrugën e Allahut”**. Ndërsa këta thonë: ‘Nuk kemi xhihad, kemi vetëm mbrojtje’.

Allahu thotë në Kur’an: **“Nëse hasni jobesimtarët në fushëbetejë, mos ua ktheni shpinën”**.

Dhe: **“Luftoni ata jobesimtarë që janë më afër”**.

Por këta thonë: 'Xhiahadi në Islam nuk është sulmues, por vetëm mbrojtës'.

Këto ide janë rezultat i propagandës dhe ndikimit të predikimit të krishterë, i cili gjithmonë ka promovuar se lufta dhe gjakderdhja janë të shëmtuara, se paqja është rruga e vetme. Për fat të keq, myslimanët i kanë besuar këto marrëzi dhe janë ulur në shtëpitë e tyre, të poshtëruar, pasi dikur krenaria e tyre valëvitej mbi kokat e tyre me anë të xhihazit në rrugën e Allahut të Lartësuar.

Ata që dikur thërrisnin për paqe dhe mëshirë, dhe e kritikonin xhihadin e myslimanëve, janë po ata që më pas vranë dhe masakruan myslimanët dhe i përzunë ata nga shtëpitë e tyre nëpër botë.

Sot, ju shihni çfarë bëjnë këta njerëz në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe çfarë krimesh kanë bërë në xhaminë e Ibrahimit (Haram Ibrahimit) në Palestinën e pushtuar.

Ata që për dekada kritikuan myslimanët si luftënxitës dhe gjakderdhës, që nga kryqëzatat e deri më sot, kanë nisur luftëra shkatërrimtare kundër myslimanëve, duke kryer masakra të tmerrshme, për të cilat nuk kemi kohë të flasim në detaje tani.

Kur njeriu lexon ato që janë shkruar në histori nga ngjarjet dhe tragjeditë e shumta, i mbushen sytë me lot për padrejtësitë që janë kryer, dhe për hipokrizinë e atyre që

flasin për paqe e marrëveshje, por në të fshehtë mbajnë hanxharët, për t'ia ngulur në zemrat e të pafajshmëve.

Po, xhihadi duhet të jetë në kuadrin islam, i përcaktuar nga Allahu i Lartësuar, dhe brenda kufijve që ka caktuar sheriat. Në xhihad nuk ka padrejtësi, as shkelje të të drejtave të të tjerëve, as ndonjë justifikim për të vrarë të pafajshmit ose për të shtypur myslimanët.

Xhihadi është një detyrë hyjnore që, nëse përmbushet siç duhet, do t'i ngrejë me krenari kokat e myslimanëve. Për këtë arsye, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e thekson fort në testamentin e tij të bekuar.

Pastaj ai thotë: *“Mbani lidhjet me njëri-tjetrin, dhurojini njëri-tjetrit dhe ruhuni nga ndarjet dhe ndërprerja e lidhjeve. Mos e lini urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, sepse do t'ju udhëheqin njerëzit më të këqij, dhe pastaj do të luteni, por nuk do t'ju pranohet lutja”*. Nëse një shoqëri mësohet të mos i thotë të keqit: *“Ti je i keq”*, ajo i hap rrugën të këqijve dhe të devijuarve, për të marrë në dorë udhëheqjen e saj. Atëherë as lutjet e të mirëve nuk do të pranohen për të shpëtuar nga ata udhëheqës të padrejtë. Kjo është porosia e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), e cila përfshinte njëzet pika që trajtonin çështjet më të rëndësishme që ai i zgjodhi dhe i shpjegoi për umetin (popullin islam).

Pas kësaj, ai u ndal te një çështje thelbësore dhe shumë e rëndësishme, çështja e hakmarrjes ndaj vrasësit të

tij. Ai tha: *“O bijtë e Abdul Mutalibit, mos ju shoh duke u zhytur në gjakun e myslimanëve, duke thënë: ‘U vra Prijësi i besimtarëve!’ Mos vritni për mua askënd tjetër përveç vrasësit tim. Shikoni, nëse vdes nga kjo goditje, atëherë goditeni edhe ju atë një herë, një goditje për një goditje. Mos ia çnderoni trupin, sepse kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) të thotë: ‘Ruhuni nga çnderimi, qoftë edhe ndaj një qeni të tërbuar’”*.

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), njohës i madh i Allahut, me një zemër hyjnore të mëshirshme, kishte frikë se mos njerëzit do të hidheshin mbi atë njeri të lig dhe do ta copëtonin, do ta shpërfytyronin.

Këto ishin fjalët e fundit të testamentit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Ne jemi të gjithë të përfshirë në këtë këshillë. Prandaj, duhet ta marrim me seriozitet dhe ta zbatojmë përmbajtjen e saj. Nuk e di sa orë jetoi Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), pasi e përfundoi porosinë e tij...

Rrugët dhe rrugicat e Kufes dhe xhamia e saj ishin të mbushura me fjalët dhe urtësitë e këtij njeriu të madh, këtij burimi të pashtershëm të mençurisë. Këto rrugë dhe xhami ruajnë kujtimet e tij në zemrat dhe veshët e tyre, por kjo dhuratë hyjnore iu mor popullit. Në një natë si ajo e kaluar, ka një frazë tjetër në *“Nehxhul Belaga”*, që ai ia tha të birit, Hasanit (Paqja qoftë mbi të!), dhe unë dëshiroj ta përmend sot – në ditën e pikëllimit për Imam Aliun (Paqja qoftë mbi

të!), ndoshta sytë tuaj do të lotojnë për fatin e këtij njeriu të madh.

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“M’u rënduan sytë nga gjumi, ndërsa isha ulur dhe më erdhi në ëndërr i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). I thashë: ‘O i Dërguari i Allahut, çfarë s’hoqa prej umetit tënd nga shtrembërimet dhe armiqësitë e tyre!’”*

Shikoni Aliun (Paqja qoftë mbi të!), qëndron para Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) sikur djali para babait të tij. Ai është rritur dhe edukuar në prehrin e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Profeti ishte si babai i tij, në të gjitha etapat e jetës. Tani, në moshën 63-vjeçare, e sheh Profetin (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) në ëndërr dhe ndien sërish atë ndjesi fëmijërie përballë të Dërguarit të Zotit. Ai ankohet para tij, siç ankohet fëmija te babai i tij dhe thotë: *“Çfarë vuajtjesh hoqa nga umeti yt, nga padrejtësitë dhe kokëfortësia e tyre!”* Dhe Profeti (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) iu përgjigj: *“Lutu kundër tyre!”* Aliu (Paqja qoftë mbi të!) tha: *“Në fakt, ai po thotë: ‘O Zot, më largo prej tyre!’”*

Dhe kjo lutje iu pranua...

Në një natë si ajo e kaluar, shokët u mblodhën rreth shtëpisë së Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Thuhet (edhe

pse nuk është përmendur në burimet historike të besueshme) se jetimët u mbledhën rreth shtëpisë dhe secili prej tyre kishte në dorë një gotë me qumësht, sepse kishin dëgjuar se Imam Aliu kishte kërkuar pak qumësht për të pirë.

Edhe pse nuk është miratuar historikisht, mund të ketë ndodhur. Ajo që është e sigurt, është se shtëpia e Aliut u mbush me dashamirë dhe adhurues që qanin me vaj, derisa doli Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të!) dhe u tha njerëzve: “Gjendja e babait tim është e rëndë, shpërndahuni”. Atëherë njerëzit u larguan...

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) kishte lënë porosi që trupi i tij i pastër të lahej dhe të varrosej natën. Kjo gjë u bë zakon te Ehli Bejti. Ashtu siç u la, u qefinos dhe u varros natën edhe Zonja Fatime (Paqja qoftë mbi të!), po ashtu, edhe Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) u la dhe u varros natën, sepse kishte shumë mundësi që ata që e kishin sharë për vite të tëra në minberët e myslimanëve, nëse do ta dinin vendin, do të shkonin ta zhvarrosnin varrin e tij dhe ta fyenin trupin e tij të pastër. Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e dinte këtë, falë largpamësisë së tij.

Kur nata u nda më dysh, ata morën trupin e tij, e varrosën dhe u kthyen.

Nuk kishte shumë njerëz në varrim, ishin vetëm fëmijët e Aliut dhe disa nga shokët e tij të ngushtë.

Mendova për trishtimin e thellë të Imam Aliut në këtë varrim të heshtur, në këtë ndarje larg syve të njerëzve, në atë shtëpi të errët, në ato ditë të vështira për Ehli Bejtin.

Nuk besoj se ka kaluar dikush më shumë dhimbje se Zejnebi (Paqja qoftë mbi të!). Ajo e pa nënën e saj të varroset natën dhe tani po sheh edhe babain e saj të varroset po ashtu, natën e kaluar.

## **Madhështia e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)**

Dëshiroj sot të flas për Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!), si dhe për djalin e tij të madhërishtëm, Imam Ruhullah Khomeinin (Rahmet pastë!), kujtimi i të cilit gjallërohet në ditët e “Dhjetëditëshit të Fitores” (Dhjetëditëshi i Bahmanit).

Për Prijësin e besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!), për rreth katërmëdhjetë shekujsh, kanë folur oratorë, shkrimtarë, mendimtarë, poetë, vajtues dhe lavdërues të Ehli Bejtit, të gjithë myslimanët, qofshin shi’itë apo suni, madje edhe jomyslimanët. Do të vazhdohet të flitet për të deri në përjetësi. Megjithatë, rrethi i fjalës për këtë personalitet të jashtëzakonshëm është aq i gjerë, saqë edhe po të hyjmë nga cilado anë, do të gjejmë aspekte ende të pathëna.

Mendova se çfarë duhet thënë, nëse duam të flasim për këtë njeri të pazakonshëm.

Nuk e kam fjalën për esencën e tij shpirtërore dhe hyjnore, që është e paarritshme, dhe që njerëz si unë nuk mund ta prekin, por e kam fjalën për atë anë të jetës dhe personalitetit të tij, të cilën njeriu mund ta shohë, të meditojë mbi të dhe ndoshta edhe ta marrë si shembull për jetën e vet.

Pashë se as një orë, as një hutbe, nuk mjaftojnë për të folur për të, sepse kjo figurë është shumëdimensionale, e

gjerë në mënyrë të pabesueshme, siç thuhet: “Ai është det, nga cilado anë që i afroresh, gjen thellësi të reja”.

Nuk është e mundur që t’i thuhet dikujt: “Ky është i tëri Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!)”, sepse nuk mund të përfshihet gjithë realiteti i tij. Por, mund të afrohem në mënyra të ndryshme dhe të flasim për aq sa na lejon kuptimi, përkushtimi dhe intuita jonë.

Mendova se ndoshta është e mundur të gjejmë njëqind cilësi të veçanta të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Kjo shifër është përmendur edhe nga disa të mëdhenj, në disa transmetime. Këto cilësi mund të përfshijnë:

- Cilësi shpirtërore, si: dituria, devotshmëria, asketizmi, durimi, butësia;
- Cilësi personale dhe morale;
- Cilësi në sjellje dhe rol, si: baba, bashkëshort, qytetar, luftëtar, udhëheqës, gjykatës;
- Cilësi në marrëdhëniet me njerëzit, si: njeri i përlurur, i drejtë, menaxhues i drejtë i punëve publike, njeri i popullit.

Po të mundej dikush t’i përshkruante këto njëqind cilësi, me një mënyrë të saktë dhe të thellë, do të kishte arritur, në një mënyrë të përgjithshme, të na japë një portret të plotë për Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!). Por edhe këto

cilësi janë kaq të thella, sa secila prej tyre meriton një libër të veçantë.

## Besimi i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)

Ai ishte një njeri me besim të palëkundur. Mendimi, bindja dhe feja ishin të rrënjosura thellë në qenien e tij.

Çfarë mase mund të përdorim që ta kuptojmë madhështinë e këtij besimi?

Ai vetë ka thënë: *“Po të më hiqej mbulesa (e të fshehtës), nuk do të shtohet aspak bindja ime”*. Domethënë: Nëse më hiqen velat dhe do të më bëhej e mundur të shihja Zotin, engjëjt, Xhenetin, Xhehenemin dhe gjithçka që feja ka përmendur nga bota e të padukshmes, me sytë e mi, bindja ime nuk do të ndryshonte, sepse ajo është *“e barabartë me bindjen e dikujt që i ka parë tashmë të gjitha këto”*.

Ky është ai besimi i thellë dhe i gjallë, që poeti arab e përshkruan me fjalë, por që nuk përshkruhet dot me pak fjali.

Ai ishte i pari që pranoi Islamin në moshë të vogël dhe e ndoqi rrugën me gjithë qenien e tij deri në frymën e fundit. Kjo është diçka që nuk shpjegohet me pak fjalë. Të gjitha këto përmasa janë shumë të mëdha dhe të gjera.

Ne kemi parë shumë njerëz të mëdhenj, kemi dëgjuar për ta, kemi lexuar për jetën e tyre në libra, dhe po të shihen me saktësi, njeriu ndien përulësi dhe vogëlsi përpara tyre.

Është si dikush që ngre kokën për të parë qiellin dhe sheh Hënën, Venerën apo Jupiterin, sa të mëdha e të ndritshme janë. Por syri ynë i kufizuar nuk është në gjendje të bëjë dallimin mes tyre dhe yjeve që janë miliona vite dritë larg, të cilat janë galaktika më vete. Të gjitha duken si dritë në qiell, por sa larg janë nga njëra-tjetra!

Po kështu është edhe krahasimi mes Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe njerëzve të mëdhenj të historisë, dijetarë, udhëheqës, shkrimtarë, politikanë, të gjithë duken të mëdhenj, por Imam Aliu është një galaktikë më vete.

## **Trimëria e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)**

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte më i guximshmi nga të guximshmit në fushën e betejës. Kurrë nuk ia ktheu shpinën armikut. Kjo nuk është pak. Historia e tij në luftën e Hendekut është e njohur, kur të gjithë hezituan, ai doli përpara.

Po ashtu në çlirimin e Khajberit, në betejën e Bedrit, në Uhud, në Hunajn, në secilën prej këtyre betejave, do të shihni se Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), në moshën 24, 25 apo 30 vjeç, e mbrojti Islamin dhe i solli fitore të mëdha, me guximin e tij në fushën e betejës. Ai bëri mrekulli me shpatën dhe besimin e tij. Kjo ishte vetëm në fushën e luftës.

Por unë them: O Ali i madh, o i dashuri i Zotit, trimëria jote në fushat e jetës është shumë më e madhe se trimëria jote në fushat e luftës. Që nga fëmijëria jote, siç përmenda më parë, rasti i të qenit i pari që pranoi Islamin, kur të gjithë e refuzuan thirrjen dhe askush nuk pati guxim ta pranojë, është vetë shkëlqimi i trimërisë.

Natyrisht, një ngjarje e tillë mund të shihet nga shumë këndvështrime e të ketë domethënie të ndryshme, por tani po e shohim atë nga këndi i guximit që përfaqëson ky akt.

## Besimi dhe besëlidhja (bej'atin)

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) e shpalli thirrjen e tij në një shoqëri, ku çdo gjë ishte kundër kësaj thirrjeje: padituria e njerëzve, fanatizmi dhe krenaria, aristokracia sunduese që nuk donte të humbte pushtetin. Në një mjedis të tillë, çfarë shprese kishte një thirrje e re?

Kur Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) zbatoi urdhrin hyjnor: **“Dhe paralajmëro të afërmit e tu më të afërt”**, ai mbledhi farefisin e vet. Mirëpo, xhaxhallarët arrogantë dhe krenarët që nuk pranonin të vërtetën dhe qeshnin me çdo fjalë të urtë, nisën ta tallnin dhe ta përqeshnin. Edhe pse ai ishte prej tyre dhe ndjenjat fisnore ishin të forta në atë kohë, ai sa luftonin për vite të tëra për të mbrojtur nderin e një farefisi, kur ky i afërm i tyre mbajti pishtarin e së vërtetës në dorë, të gjithë kthyen kokën nga ana tjetër, e injoruan dhe e përçmuan.

Atëherë, u ngrit ky djalosh dhe tha: *“Unë, o i Dërguari i Allahut!”*

Po, ai kishte besuar edhe më herët, por këtu e shpalli publikisht besimin e tij.

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte ai besimtar që nuk e fshehu asnjëherë besimin e tij, përveç disa ditëve të para, ndërkohë që shumica e myslimanëve e mbajtën

besimin të fshehur me vite, nga frika e persekutimeve. Por të gjithë e dinin se Aliu (Paqja qoftë mbi të!) kishte qenë me Profetin Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) që nga fillimi.

Përfytyrojeni mirë këtë pamje: Në një kohë kur njerëzit e mëdhenj të shoqërisë talleshin, përçmonin, i pasuri e poeti, i ulëti e i poshtri ofendonin, ai qëndroi si një mal i palëkundur mes kësaj stuhie dhe tha me vendosmëri: *“Unë kam njohur Allahun, kam njohur këtë rrugë dhe do të qëndroj në të”*. Kjo është trimëri! Kjo trimëri u manifestua në Mekë, në Medinë dhe në çdo vend ku u kërkua besëlidhje ndaj Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) e kërkoi besëlidhjen (bej'atin) nga myslimanët disa herë gjatë jetës së tij. Njëra nga më të vështirat ishte “Bej'ati i pemës” (Baj'atul Riduan) në ngjarjen e Hudejbijes. Kur situata u tensionua, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) mblodhi rreth vetes më shumë se njëmijë vetë që e rrethonin dhe tha: “A do të ma jepni besën, për të mos ikur dhe për të luftuar deri në vdekje apo fitore?”

Sipas asaj që thuhet në librat historikë dhe që është transmetuar gjerësisht, në atë grup kishte njerëz me besim të fortë, por edhe disa të dobët, madje edhe hipokritë.

I pari që i dha besën Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ishte ky i ri, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), i cili ishte rreth njëzet e ca vjeç. Ai ngriti dorën dhe tha: “Unë ta jap besën time, deri në vdekje”.

Pastaj, të tjerët morën guxim dhe filluan t’i japin besën, një nga një. Edhe ata që nuk dëshironin, u detyruan t’i japin besën. Zoti i Madhëruar shpalli: **“Allahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t’u betuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte se ç’kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi<sup>1</sup> dhe i shpërbleu me një fitore të afërt”.<sup>2</sup>**

Kjo është trimëri. Gjatë gjithë jetës së Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), kudo që kishte nevojë për të treguar zemër e vullnet, ishte ky njeri i madh ai që dilte i pari. Ai ishte në ballë në çdo sprovim, i pari në çdo sakrificë, i vendosur në çdo betejë, pa frikë dhe pa lëkundje.

---

<sup>1</sup> Shih shënimin në vargun 248 të sures 2.

<sup>2</sup> Sure “El Fet’h”, ajeti 18.

## **Përmasat e personalitetit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), një mësim i përjetshëm që nuk harrohet**

Ekzistenca e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), në shumë aspekte dhe në rrethana të ndryshme, përbën një mësim të përjetshëm që nuk harrohet kurrë për të gjitha brezat njerëzorë, qoftë në veprimet personale, në mihrabin e adhurimit të tij, në lutjet e tij të përkushtuara, në asketizmin e tij, në zhytjen e tij të thellë në mendimin për Allahun, në luftën e tij ndaj egos, ndaj djallit dhe dëshirave materiale e shpirtërore.

## Asketizmi i tij (zuhdi)

Fjalët që Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) i ka thënë në hapësirën e krijimit dhe në lidhje me jetën e njeriut, kanë jehuar fuqishëm dhe kanë mbetur në mendjet e njerëzve: *“O dynja, largoju prej meje! A po më afrohesh mua? Apo po më josh? Nuk është koha jote. Largohu, josh dikë tjetër! Unë nuk kam nevojë për ty! Të kam ndarë tri herë, pa kthim! Jeta jote është e shkurtër, rreziku yt i vogël dhe shpresa në ty është e ulët. Ah! Ah! Sa pak është furnizimi, sa i gjatë është udhëtimi, sa e largët është rruga dhe sa e madhërishme është ndalesa!”*

## **Lufta dhe përkushtimi i tij (xhihadi)**

Nga një kënd tjetër, ai ishte një luftëtar për vendosjen dhe forcimin e së drejtës dhe drejtësisë. Që nga dita kur Profeti i madh (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) mori mbi supe barrën e shpalljes, Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte pranë tij, si luftëtar, si besimtar dhe si sakrifikues.

Që nga fëmijëria e tij dhe deri në orët e fundit të jetës së tij të bekuar, Imam Aliu qëndroi krah për krah me misionin e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ai luftoi pa ndërprerje për të forcuar themelet e sistemit islam dhe për ta ruajtur atë, dhe nuk e braktisi kurrë këtë mision, as për një moment të vetëm. Ai e 'kishte blerë' Islamin me jetën e tij, dhe kishte shkrirë veten në rrugën e përpjekjes për të vendosur të drejtën dhe drejtësinë.

Në ato çaste kur nuk mbetej askush tjetër në fushë, ai qëndronte. Kur askush nuk bënte hap përpara, ai hidhte hapin i pari. Kur ngarkesa e xhihadi në rrugë të Allahut ishte e rëndë si malet mbi supet e luftëtarëve dhe e vështirë për shumëkënd, figura e Aliut qëndronte si shtyllë dhe u jepte të tjerëve shpresë dhe siguri. Ky ishte vetë kuptimi i jetës për të. Ai i vuri në shërbim të së vërtetës të gjitha

dhuntitë që ia kishte dhënë Allahu, forcën fizike, shpirtin, vullnetin, dhe i përdori për të lartësuar fjalën e së vërtetës. Me forcën e vullnetit dhe të krahëve të tij, ai e ngjalli këtë të vërtetë.

Sot e shihni se koncepte si drejtësia, e drejta, humanizmi dhe vlerat e larta njerëzore, janë gjithnjë e më të forta dhe më të qëndrueshme çdo ditë që kalon. Dhe kjo është falë ekzistencës së atyre që ecën në rrugën e Ali ibn ebu Talibit gjatë gjithë historisë.

Edhe pse këta janë të paktë në numër, prapëseprapë, kanë mbjellë vlerat njerëzore në çdo kohë. Parimet e jetës, qytetërimit, kulturës, shpresat dhe idealet e larta që njerëzimi i ruan sot, janë të gjitha falë Imam Aliut dhe figurave të mëdha të historisë njerëzore.

## **Kuptimi i vërtetë i qeverisjes – një tjetër dimension i jetës së Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)**

Kur ky njeri i madh, me mendim të lartë dhe vizion të thellë, më në fund arriti në pozitën e udhëheqësit dhe qeverisjes, në atë periudhë të shkurtër, kur u bë udhëheqës i përgjithshëm i myslimanëve, veproi në një mënyrë të tillë, që edhe nëse historianët, shkrimtarët dhe artistët do të shkruajnë për vite me radhë rreth jetës së tij gjatë qeverisjes, nuk do të jenë në gjendje ta përshkruajnë siç duhet.

Ai e mishëroi kuptimin e vërtetë të një qeverisjeje hyjnore, mishëroi drejtësinë absolute, afroi të varfrit dhe të nënshtruarit, u dha kujdes të posaçëm të dobëtëve dhe largoi nga skena njerëzit që zotëronin pasuri të paligjshme, pushtet të padrejtë dhe ndikim të pavend, sepse ata ishin vetë burimi i padrejtësisë dhe shtypjes. E zbatoi Kur'anin në jetën e myslimanëve. Ishte shembulli i gjallë i ajetit: **“Të ashpër ndaj jobesimtarëve, të mëshirshëm mes vete”**.

Në syrin e Aliut, ata që nuk kishin të drejtë, ishin të barabartë me baltën. Por ai që kishte vlerë për të, ishte ai që kishte: besim, devotshmëri, sinqeritet, guxim në rrugën e Allahut, dhe njerëzi të vërtetë.

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) qeverisi për më pak se pesë vjet, por dijetarët kanë shkruar për shekuj të tërë për të dhe ende po shkruajnë. Sa kanë shkruar! edhe pse është shkuar dhe vazhdohet të shkruhet, askush nuk ka mundur të japë një pasqyrë të plotë të jetës së tij. Të gjithë pranojnë mangësinë dhe pafuqinë e tyre përballë madhësisë së këtij njeriu.

## **Të kapemi pas udhëheqjes së Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)**

Ne jemi njerëz që njihemi për dashurinë ndaj Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Popujt e botës na njohin për besnikërinë tonë ndaj tij. Na njohin si njerëz që kemi përkushtim, dashuri, bindje dhe lidhje të veçantë me Aliun (Paqja qoftë mbi të!). Prandaj duhet të jemi të denjë për këtë lidhje dhe të jemi në nivelin e kësaj pritshmërie.

Ka qenë një kohë kur, kur dikush thoshte: *“Falënderimi i qoftë Allahut që na bëri prej atyre që janë të lidhur me udhëheqjen e Imam Aliut dhe pasardhësve të tij të pastër”*. Shumëkush dyshonte në vërtetësinë e kësaj fjale. Atë ditë, kur në këtë vend sundonin Amerika, sionistët dhe armiqët e Allahut, kur sistemi shoqëror ishte nën ndikimin e ideve, kulturës dhe sjelljes së armiqve të Allahut, kur vendimet dhe fatet e shtetit ishin në duart e tyre, si mund të kishim ne të drejtë të thoshim: *“Falënderimi i qoftë Allahut që na bëri nga ata që janë të lidhur me udhëheqjen e Prijësit të besimtarëve (Aliut)?!”* Po, një pjesë e njerëzve ishin të lidhur me dashurinë dhe besimin në udhëheqjen shpirtërore të tij, por vilajeti është më shumë se sa kaq.

Sot, populli ynë mund ta falënderojë Allahun për kapjen fort pas udhëheqjes së Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Rruga e Revolucionit, rruga e qeverisjes sipas Aliut

është rruga e Islamit. Aliu (Paqja qoftë mbi të!) është shembulli më i lartë, udhëheqësi i karvanit, komandanti i ushtrisë dhe luftëtari i pandalshëm në rrugën e Islamit. Ai jetoi për Islamin dhe u martirizua për të. Drita e ekzistencës së tij vazhdon të shkëlqejë deri më sot, rrezatimi i personalitetit të tij shpërndahet ende si dritë ndriçuese në rrugën e Islamit.

## **Universiteti i Aliut**

Ne duam një botë, një jetë dhe një sistem ku Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) të mund të ecë në atë rrugë. Çdo njeri në këtë sistem duhet të jetojë dhe të luftojë sikur Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) të ishte vetë udhëheqësi i drejtpërdrejtë i shoqërisë dhe të kujdesej për të. Shoqëria jonë dhe sistemi ynë duhet të jenë të denjë për të.

Ne duhet të veprojmë në këtë mënyrë. Duhet të punojmë që vendi dhe shoqëria jonë të jetë një shoqëri sipas modelit të Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Emri “Islam” ose emri “i lindur mysliman” nuk mjafton, sidomos për ata që mbajnë përgjegjësi mbi supe, qoftë në: sistemin gjyqësor, sistemin ligjvënës, sistemin e sigurisë dhe rendit, forcat e armatosura, apo çdo institucion tjetër.

Fjala dhe vepra duhet të përputhen. Besimi në udhëheqjen e Aliut (Paqja qoftë mbi të!) nuk duhet të jetë vetëm një shprehje goje, por i plotë dhe i thellë.

## **Shërbimi ndaj popullit dhe të shtypurve**

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) punonte për hir të Allahut dhe në rrugën e Tij, dhe përpiquej t'u lehtësonte dhimbjet njerëzve, i donte njerëzit dhe e shihte detyrë të vetën t'u shërbente atyre. Qeveria e tij ishte themeluar për t'u shërbyer të shtypurve. Madje ai nuk mjaftohej me kaq, shkonte natën, i vetëm, nga njëri te tjetri, për të ndihmuar të varfrit e braktisur. Kjo ishte jeta e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).

Në sistemin tonë, çdo lëvizje, çdo politikë, çdo ligj dhe çdo përpjekje duhet të jetë në shërbim të të varfërve e të shtypurve, atyre që për vite janë shtypur nga qeveritë e padrejta dhe tiranike në forma të ndryshme, dhe që janë përballur me dobësi dhe përlulje.

Kjo është rruga jonë, rruga e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), rruga që hodhi Imam Khomeini (r.a) për këtë revolucion, rruga që ai e mësoi nga Aliu (Paqja qoftë mbi të!). Duhet të ecim në këtë rrugë.

## **Lufta kundër padrejtësisë**

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) luftonte kundër padrejtësisë, kudo që të ishte, me çfarëdo emri dhe nën çdo maskë që ajo fshihej. Shikoni jetën e vështirë të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), shikoni kë luftoi, si luftoi, në ç' mënyrë luftoi dhe me çfarë force e vendosmërie qëndroi përballë saj. Padrejtësia maskohej me emra dhe tituj të ndryshëm, por, kur ai kuptonte që përballë kishte të padrejtë dhe të pavërtetë, nuk ngurronte dhe nuk vonohej ta përballonte.

Kjo është rruga jonë, rruga e vështirë që duhet ta kalojmë. Rruga e atyre që, një nga një, i binden Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe përballen me padrejtësinë dhe tiraninë, në çdo nivel dhe me çdo mënyrë.

## **Mësime dhe porosi nga jeta e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!)**

Ali ibn ebu Talibi nuk është vetëm një figurë historike. Ai është “Emirul Mu’minin”, Prijësi i besimtarëve, pra, për ne është shembull, model dhe udhërrëfyes. Ai është modeli i qeverisjes që duhet ndjekur nga sundimtarët dhe udhëheqësit. Myslimanët duhet të marrin si shembull sjelljen dhe metodën e Aliut (Paqja qoftë mbi të!) në jetën e tyre personale dhe publike.

Sot, pasi Allahu na ka nderuar me krijimin e Republikës Islamike, e cila me përpjekjet e myslimanëve dhe me sakrifica të mëdha e ka dëshmuar seriozitetin e saj në botë, të gjithë ata që mbajnë në dorë pushtetin dhe të gjithë ata që do ta marrin atë në të ardhmen, duhet të punojnë dhe të planifikojnë për të realizuar këtë model.

Modeli shërben për ndërtimin dhe ringjalljen e njeriut mysliman. Këtë e kishim të pamundur gjatë regjimit të errët të Shahut, i cili nuk lejonte aspak një jetë sipas vlerave islame – që të jetoje si mysliman dhe të mbeteshe mysliman. Por sot, kjo mundësi ekziston dhe duhet shfrytëzuar në hijen e sistemit të Republikës Islamike.

Personaliteti i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) është i aftë të jetë shembull si për ndërtimin e njeriut mysliman, ashtu edhe për të mësuar se si duhet të jetojë një mysliman.

Prandaj, nëse duam të flasim për Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!), nuk duhet ta bëjmë këtë vetëm për bekim apo përmendje të tij, por për të mësuar prej tij dhe për të ndriçuar rrugën tonë me dritën e jetës së tij, për të zgjidhur problemet dhe për të kapërcyer pengesat që përballen sot Republika Islamike, në përballje me forcat arrogante të lindjes dhe perëndimit, të cilat nuk pajtohen me vlerat islame dhe duan ta përkulin sistemin ndaj interesave imperialiste apo socialiste.

Të gjithë ata që ndjekin me kujdes zhvillimet dhe çështjet politike në botë e dinë se çdo revolucion përballen me sfida dhe vështirësi, kjo është normale. Por, përballë këtyre sfidave, ne duhet të kërkojmë rrugëzgjdhje, dhe në këtë mënyrë, çdo problem ka një fund dhe çdo nyje mund të zgjidhet. Për të gjetur rrugën e shpëtimit, kthehemi te jeta e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), sepse ajo na hap portat e zgjidhjes.

Këtu do të ndalem në disa aspekte të personalitetit të tij, veçanërisht në formën e udhëheqjes dhe të qeverisjes së tij. Më pas duhet të përpiqemi të krahasojmë jetën dhe rrugën tonë me atë të Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Nëse duam të qëndrojmë te pikat më të ndritura dhe madhështore të

jetës së zotërisë së të devotshmëve, duhet të studiojmë dy pika themelore e të ndjeshme.

Mendoj se personaliteti i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), në cilësinë e udhëheqësit dhe kalifit të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), përqendrohet në këto pika.

Natyrisht, nuk do të flasim këtu për dimensionin shpirtëror dhe mistik të Aliut, që ishte gjithmonë i lidhur me rrezet dhe mirësinë e Allahut të Madhëruar. Këtu do të flasim për Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) si udhëheqës islam që qeverisi umetin për një periudhë kohore. Për ta kuptuar realisht personalitetin dhe stilin e këtij udhëheqësi, do ta trajtojmë çështjen fillimisht në mënyrë të përgjithshme e pastaj më hollësisht.

## **Pika e parë: Devotshmëria e plotë ndaj Islamit dhe sheriatit**

Ajo që bie më shumë në sy në jetën e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), si udhëheqës, është përkushtimi i tij i plotë ndaj mësimave të Islamit dhe ligjeve të tij. Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) u rrit nën kujdesin e Islamit. Në kohën kur Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) qeveriste dhe duronte vështirësi për hir të fesë, Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte i riu trim që nuk rrinte në shtëpi duke pritur ngjarjet, ai ishte gjithmonë në fushëbetejë dhe në ballë të sfidave. Ai vuri në shërbim të Islamit të gjitha mundësitë dhe cilësitë e tij njerëzore, mori pjesë në të gjitha betejat në kohën e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), përveç një beteje, ku me urdhër të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) mbeti në Medinë. Ai ia fali jetën Islamit dhe ishte gjithmonë gati të sakrifikonte shpirtin për ta mbrojtur fenë.

Në ditën kur myslimanët zgjodhën dikë tjetër për udhëheqës, përveç Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe disa njerëz u larguan nga ai për t'i dhënë besën dikujt tjetër, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), që e dinte se kalifati ishte e drejta e tij, dhe kishte mundësi të reagoje, t'i thërriste njerëzit, të kërkonte ndihmë, nuk e bëri këtë, por e la mënjatë të drejtën e tij për të ruajtur interesin e Islamit.

E njëjta gjë ndodhi edhe pas vdekjes së kalifit të dytë, kur ai u ftua të marrë pjesë në këshillin prej gjashtë vetash. Kur ata i thanë: 'Prano të qeverisësh sipas Sunetit të Profetit dhe metodës së dy kalifëve para teje, dhe do të ta japim besën', Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e refuzoi, sepse kjo ishte kundër bindjes dhe detyrimit të tij fetar. Ky refuzim e bëri atë të vonojë marrjen e kalifatit edhe për 12 vite të tjera.

Gjatë gjithë jetës së tij, para kalifatit, ai gjithmonë përpiquej dhe luftonte për ruajtjen e Islamit, prandaj ishte krejtësisht natyrale që, kur erdhi në pushtet, ai të përpiquej të vendoste ligjet dhe vlerat e Islamit. Kjo është veçoria e parë e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) si udhëheqës.

Nëse dëshironi të krahasoni Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) me ata që i dolën kundër, do të shihni një dallim të madh. Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) nuk kërkonte pushtet për vete, ai vepronte vetëm për hir të Islamit që e njihte dhe në të cilin besonte.

Shpresoj t'i kushtoni vëmendje të veçantë, pasi e kam përmendur shumë herë, është se sot kemi më shumë nevojë se kurrë për të njohur bazat islame, kur'anore dhe fetare. Të gjithë ne duhet të mësojmë dhe të kuptojmë se çfarë kërkon Islami dhe si e paraqet ai mendimin e tij në çdo fushë dhe aspekt të jetës. Çështja më thelbësore sot është të njohim Islamin. Një nga mënyrat për ta kuptuar më mirë Islamin dhe për të ditur çfarë kërkon ai prej nesh, është të njohim

jetën dhe metodën e njerëzve hyjnorë, ndër ta edhe Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!).

Prandaj, kur flasim për Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!), qëllimi nuk është vetëm të përmendim virtytet e tij si një figurë historike e madhe islame, por, përmes tij, të njohim vetë Islamin, sepse ne e kuptojmë Islamin nëpërmjet Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).

Tani kalojmë te pika e dytë e personalitetit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), që ka të bëjë me rolin e tij si një udhëheqës islam. Aliu (Paqja qoftë mbi të!), si udhëheqës, nuk ishte kurrë i gatshëm të bëjë kompromise apo marrëveshje me njerëz që nuk e ndiqnin rrugën e tij, me ata që nuk ishin në linjën e Islamit dhe të përkushtimit ndaj Allahut. Jeta e tij është dëshmi për këtë.

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), nxënësi i Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), nuk bënte kompromise, njësoj si vetë Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili punonte për realizimin e qëllimeve të shenjta dhe nuk i nënshtrohej tekave dhe interesave personale.

Po të ishte Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) i gatshëm të bënte kompromise, do të mund t'i qetësonte kundërshtarët e tij, të fuqishmit e kohës, figurat e njohura që kishin ndikim dhe respekt në mesin e njerëzve, dhe do të

mund t'i mbyllte gojët që e kritikonin. Nëse do të kishte zgjedhur një qasje më të butë ndaj kundërshtarëve të Islamit dhe të qeverisë islame, nuk do të ishte përballur me kaq shumë vështirësi dhe sfida. Kjo është ajo që e dallonte dhe e dallon Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) nga të tjerët që kanë sunduar dhe sundojnë.

Ata ishin të gatshëm të bënin aleanca me këdo për të luftuar kundërshtarin e tyre. Ne shohim se Muavia dhe Amr ibn Asi, megjithëse kundërshtarë mes vete, u bashkuan kundër Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).

Edhe Talha dhe Zubejri, ndonëse të ndryshëm nga Muavia, u bashkuan për të luftuar Aliun (Paqja qoftë mbi të!).

Ndërsa Aliu (Paqja qoftë mbi të!) nuk pranoi asnjë aleancë të tillë. Ai nuk pranoi të bashkëpunojë me Talhën dhe Zubejrin për të luftuar Muavian, sepse për të, të gjithë ata ishin në konflikt me të vërtetën dhe Islamin. Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e konsideronte të papranueshme një aleancë me njerëz që nuk ishin në rrugën e drejtë, edhe nëse kjo do ta forconte pozitën e tij.

Kjo është një tjetër veçori madhore e Aliut (Paqja qoftë mbi të!).

Ai vetë thotë: *“M'u mbushën sytë, kur i pashë njerëzit që erdhën drejt meje si tufa ujqish, që më rrethonin nga të gjitha anët,*

*saqë Hasani dhe Hyseni u shtypën nën këmbë dhe më shtrëngonin nga të dy anët, si delet kur grumbullohen te bariu”.*

Në një vend tjetër ai thotë: *“Pasha Allahun, po të mos ishte prania e njerëzve dhe dëshmia e tyre se unë jam mbrojtësi i tyre dhe Allahu ua ka bërë detyrim dijetarëve të mos rrinë të heshtur përballë padrejtësisë së shtypësve dhe urisë së të shtypurve, do ta kisha hedhur këtë barrë nga qafa ime dhe do ta lija pas shpine. Kjo dynja, për mua, do të kishte qenë më e pavlerë se era e një dhie”.*

Sot, ne duhet të mësojmë nga jeta e këtyre mësuesve të njerëzimit, nga imamët e drejtë. Të mësojmë prej fjalëve të tyre ndriçuese – për jetën, sinqeritetin, sakrificën, që drejtësia e Islamit të përhapet në botë.

Dua të ndalem shkurtimisht te një ngjarje që lidhet me hutben e famshme “Shekshikijeh” të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), por para se të flas për hutben, po tregoj një histori, që ndoshta e keni dëgjuar.

Në një nga luftërat e tij, gjatë një pushimi të shkurtër, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) u tërhoq në çadrën e tij, duke u përgatitur për betejën e ardhshme. Ibn Abasi hyri në çadër dhe e pa Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) duke rregulluar këpucën e tij të vjetër, sepse në luftë, këpuca duhej të ishte e qëndrueshme dhe e fortë për lëvizje të shpejtë. Aliu (Paqja qoftë mbi të!) kishte shfrytëzuar këtë pushim të shkurtër për të rregulluar këpucën e vjetër e të

grisur, edhe pse në atë moment ai ishte sundimtari i një perandorie të madhe islame që shtrihej në Iran, Afganistan, Irak, Egjipt dhe Jemen (përveç Shamit).

Ky udhëheqës i madh, komandant i përgjithshëm i një ushtrie të madhe islame, ishte ulur dhe po qepte këpucën e tij. Ibn Abasi e vështroi me habi këtë skenë të thjeshtë, por me kuptim të thellë. Aliu (Paqja qoftë mbi të!) iu kthye dhe e pyeti: “Sa vlen kjo këpucë?”

Sigurisht që nuk vlente asgjë, ishte e vjetër dhe e grisur, e po e riparonte një njeri që nuk ishte këpucar.

Ibn Abasi u përgjigj: “Nuk ka fare vlerë”.

Atëherë Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) deklaroi: “Pasha Allahun, kjo këpucë është më e vlefshme për mua se sa sundimi juaj, përveç në rastin kur përmes tij mund të vendoset drejtësia dhe të parandalohet padrejtësia”. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se kalifati dhe udhëheqja për të nuk ishin synim në vetvete, por një mjet për të realizuar qëllime hyjnore. Qeverisja e tij ishte një qeverisje e fesë. Ai deshi të bëhej udhëheqës vetëm për të vendosur të drejtën dhe për të larguar të kotën. Ai nuk ishte i etur për pushtet, por e pranoi pozitën e udhëheqësit për të udhëhequr shoqërinë islame dhe për të çuar përpara të vërtetën.

Tani le të rikthehemi te Hutba Shekshikije, ku Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) përshkruan ngjarjet që çuan në

kalifatin e tij, që nga vdekja e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) deri sa kalifati i kaloi atij. Ai thotë: *“Nuk e prisja, por njerëzit më rrethuan si qime qafe të iriqit, aq sa Hasani dhe Hyseni u shtypën nën këmbë...”* Kjo do të thotë se ngulmimi i popullit për ta bërë atë kalif ishte i jashtëzakonshëm, aq sa ai më në fund pranoi. Por pse pranoi?

Ai vetë shpjegon qëllimin, kur thotë: *“Pasha Allahun, po të mos ishte prania e njerëzve, prova e mbështetjes dhe amaneti që Allahu u ka dhënë dijetarëve që të mos pajtohen me padrejtësinë e shtypësve dhe urinë e të shtypurve, do ta kisha hedhur këtë barrë [të kalifatit] dhe do të isha larguar...”*

Pra, në këndvështrimin islam, qeverisja është një akt adhurimi, kur ka qëllim dhe drejtim të qartë. Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e pranoi kalifatin për tri arsye:

**E para:** Kërkesa e popullit dhe këmbëngulja e tyre e vazhdueshme, që është faktor i rëndësishëm në marrjen e përgjegjësisë.

**E dyta:** Mbështetja reale. Ai pa që kishte ndihmës dhe mbështetje, përndryshe nuk do ta pranonte.

**E treta:** Detyrimi hyjnor ndaj dijetarëve, që të mos heshtin përballë padrejtësisë dhe të ndihmojnë të shtypurit.

Këto ishin parimet mbi të cilat ai e ndërtoi pranimin e kalifatit.

Sot, nëse dikush nuk beson në Allahun dhe nuk e pranon Islamin si një program të jetës, nëse ai është i ndikuar nga ideologji të huaja, nacionaliste, materialiste apo nga një “Islam” i fragmentuar sipas qejfit, një njeri i tillë nuk mund të formojë një qeveri hyjnore. E nëse nuk ka një qeveri të tillë, atëherë nuk do të ketë kurrë një shoqëri të vërtetë islame.

Këtu ju ftoj të jeni të vetëdijshëm dhe të zgjuar, sepse sot, kur e shikojmë me distancë historike, e shohim qartë se Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte njeriu i së drejtës, ndërsa Muavia ishte njeriu i padrejtësisë dhe i dinakërisë. Por në atë kohë, kur ndodhi lufta mes Aliut dhe Muavias, shumë njerëz, madje edhe nga shokët e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), u bashkuan me Muavian, madje disa prej tyre besonin se po bënë të drejtën dhe thoshin: “Muavia është daja i besimtarëve!”

Në atë kohë, kërkohej shumë vetëdije dhe zgjuarsi për të dalluar të drejtën nga e padrejta.

Një shembull i qartë i kësaj vetëdijeje ishte Amar ibn Jasiri. Kur disa njerëz kishin dyshime, ai u tha: “Pasha Allahun, unë kam parë këtë flamur nën të cilin është sot Muavia, në betejën e Bedrit, ku ishte në dorën e Ebu Sufjanit”.

Pra, vetëdija dhe vëmendja janë gjithmonë thelbësore.

## **Fryma e historisë sonë është në kujtimin e jetës së imamëve tanë të drejtë**

Po të mos ishte për figurat madhështore si Imam Aliu, Imam Hasani, Imam Hyseni dhe Fatime Zehrasë (Paqja qoftë mbi ta!), nuk do të kishte mbetur asnjë gjurmë e Shi'izmit, madje as vetë e Islamit, përveç nëpër disa libra të harruar. Ky Islam është ruajtur përmes përmendjes së Aliut (Paqja qoftë mbi të!), përmes luftës dhe martirizimit të atyre të mëdhenj.

Siç e dini, ndjenjat e njerëzve dhe dashuria e tyre ndaj Ehli Bejtit shpërthejnë në kulm gjatë përkujtimit të gëzimeve dhe pikëllimeve të tyre.

Sot është përvjetori i plagosjes së Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), një natë plot dhimbje e pikëllim... Zemërimi në Kufe... Nuk mund ta përfytyroni se si ishte qyteti i Kufes atë natë. Të gjithë ishin me zi e të pikëlluar, sepse kishte ndërruar jetë ai që i ngushëllonte të tjerët, ai që ishte shoku i tyre në vështirësi. Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte ai që i përkrahte e i mbështeste. Një herë i kishte shkruar njërit prej guvernatorëve të tij: *"A të mjafton të të thërrasin 'O prijës i besimtarëve', ndërsa nuk ndan me ta vuajtjet e kohës?"*

Imami Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte pjesë e jetës së njerëzve, pjesë e dhimbjeve dhe halleve të tyre. Në testamentin e tij kujton: *"Kujdes, kujdes për jetimët!"* Ishte i pari në përkujdesjen ndaj jetimëve, sepse jetimi ka më shumë nevojë për dhembshuri e përkujdesje se kushdo tjetër. Ai është i privuar nga buzëqeshja prindërore, nga ledhatimi i babait... Kush mund ta mbushë këtë boshllëk?

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) dilte natën për të shkuar te shtëpitë që i njihte, duke marrë me vete miell, oriz dhe vaj, i ndihmonte me ndezjen e furrës, i ngushëllonte jetimët, i merrte në prehër, i përkëdhelte që ata të mos ndienin trishtim dhe vetmi.

Madhështia e Aliut Aliu (Paqja qoftë mbi të!) në luftë është e njohur, por më madhështore se ajo është shërbimi dhe përkushtimi i tij ndaj të varfërve dhe jetimëve, ndaj atyre që kishin nevojë për dashuri.

Në natën e 20-të të Ramazanit, jetimët e prisnin atë burrë të ulej me ta, t'i përkëdhelte, t'u jepte për të ngrënë me dorën e tij, por ai nuk erdhi. Në atë natë, ata e kuptuan se kush ishte ai.

Ndoshta keni dëgjuar se, kur mjeku që e mjekonte Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!), kërkoi t'i sillnin qumësht, me shpresë se do ta ndihmonte kundër helmit, dhjetëra jetimë erdhën nga të gjitha anët e Kufes, çdonjëri me nga një

kupë qumështi në dorë, që t'i kthenin të paktën një pjesë të dashurisë që kishin marrë nga ai burrë.

Mbase keni dëgjuar edhe për atë plakun e verbër që në atë natë po vuante nga uria dhe vetmia. Kur e pyetën: “Si ia ke dalë më parë?”, ai u përgjigj: “Një burrë vinte tek unë, më ushqente me dorën e tij dhe më bënte shoqëri”. Kur e përshkroi atë njeri, doli se ai ishte Aliu (Paqja qoftë mbi të!).

Ky njeri me cilësi të pafundme, ishte ai për të cilin i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) kishte thënë: “*O Ali, ti je ndarësi mes së drejtës dhe së kotës*”.

Ishte strehë dhe mbrojtje për çdo të dobët, të nevojshëm dhe të vetmuar. Ai që binte pa ndjenja në mihrabin e lutjes nga frika ndaj Allahut, ishte po ai që nuk mund ta duronte ekzistencën e një guvernatori tiran si Muavija, dhe qortonte edhe shokët e tij të afërt, kur i shihte se kishin pranuar ftesa nga aristokratët për darka e luks.

Ishte ai që ruante pasurinë publike me përpikëri të jashtëzakonshme, saqë në natën e parë të marrjes së kalifatit, ai e fik dritën që digjej nga thesari i myslimanëve, për të mos shpenzuar diçka që nuk i takonte.

Ky imam ishte shembulli i mbrojtjes së njeriut dhe i të drejtave të tij. Ky është Islami i vërtetë, që manifestohet me teuhid (besimin në një Zot) në të gjitha dimensionet e tij,

me nderimin e njeriut, me barazinë, dhe me vëllazërinë mes njerëzve.

Kushdo që del nga kjo rrugë, edhe nëse duket se është mysliman, zemra e tij nuk ka besuar ende me të vërtetë në Allahun dhe në Kur'an.

Kush është i robëruar pas pasurive, epsheve, luksit, pozitive të zbukuruara me shkëlqime false, kush sheh pushtetin si burim përfitimi personal, një njeri i tillë nuk mund të quhet ndjekës i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), as trashëgimtar i tij.

Të gjithë ne duhet ta kujtojmë këtë kriter, sepse ne jemi ata që e thërrasim emrin e Imam Aliut Aliu (Paqja qoftë mbi të!), që pretendojmë se ndjekim rrugën e tij.

Kjo ka qenë gjithmonë fjala jonë dhe mesazhi ynë, për 20 apo 30 vjet, dhe nuk ka ndryshuar kurrë. Sot është më e qartë se kurrë që kjo nuk ka qenë vetëm një parullë boshe, por një rrugë jetësore. Ende jemi në provë, në sprovë. Ashtu si ju kemi thënë dje 'shfaqni atë në të cilën besoni, mësoni dhe kuptoni këtë rrugë dhe bëjeni pjesë të jetës suaj personale', edhe sot po përsërisim të njëjtën gjë, sepse duam një shoqëri që ndjek shembullin e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), që frymëzohet prej tij, sepse Islami i pastër buron prej tij.

Marrë nga: <https://alwelayah.net/>-----

## Përmbajtja

|                                                                                                             |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) në fjalët e Sejid Ali Khameneit ( <i>Allahu e ruajttë!</i> ).....           | 5  |
| Besimi në Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) .....                                                            | 6  |
| Lufta e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) kundër arrogantëve.....                   | 7  |
| Shembulli më i mirë.....                                                                                    | 8  |
| Ecja në rrugën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) .....                            | 10 |
| Porosia e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) .....                                                            | 11 |
| Ndër porositë e tij drejtuar Hasanit dhe Hysenit Paqja qoftë mbi ta!).....                                  | 13 |
| Madhështia e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).....                                                          | 33 |
| Besimi i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) .....                                                             | 36 |
| Trimëria e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) .....                                                           | 38 |
| Besimi dhe besëlidhja (bej'atin) .....                                                                      | 39 |
| Përmasat e personalitetit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), një mësim i përjetshëm që nuk harrohet ..... | 42 |
| Asketizmi i tij (zuhdi).....                                                                                | 43 |
| Lufta dhe përkushtimi i tij (xhihadi).....                                                                  | 44 |

|                                                                                                         |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Kuptimi i vërtetë i qeverisjes – një tjetër dimension i jetës së Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) ..... | 46 |
| Të kapemi pas udhëheqjes së Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) .....                                      | 48 |
| Universiteti i Aliut .....                                                                              | 50 |
| Shërbimi ndaj popullit dhe të shtypurve.....                                                            | 51 |
| Lufta kundër padrejtësisë .....                                                                         | 52 |
| Mësime dhe porosi nga jeta e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) .....                                     | 53 |
| Fryma e historisë sonë është në kujtimin e jetës së imamëve tanë të drejtë.....                         | 64 |

الامام علي (عليه السلام)  
في كلمات الإمام الخامنئي (دام ظله)

تيرانا 2026

اسم الكتاب: الامام علي (عليه السلام) في كلمات الإمام الخامنه (دام ظله

المترجم: الحاج ولنت مريا

التصحیح الأدبي: بریدا کولا

التصحیح اللغوی: إسراء مریا

الخراج النهائي و تصمim الغلاف: صبریه فزا

ناشر: جمعية النسم - تیرانا - ألبانیا